



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:261316
Datë: 31.01.2025
Numri i dokumentit: 06787707

Rev.nr.443/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Muhamet Rexha dhe Milena Đerić, anëtar, në çështjen juridike të paditësit B. M. nga fshati M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gent Spahija Avokat nga avokatura "Kërveshi & Partners" nga Prishtina, kundër të paditurës Telekom i Kosovës sh.a, në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson R. Xh. zyrtare ligjore, me objekt kontesti kompensim i diferencës së pagës, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3461/2022, të datës 05.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet i bazuar revizioni i paditësit B. M. nga fshati M., priset aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3461/2022, i datës 05.03.2024 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.2803/19, të datës 14.03.2022, në pikën I., të dispozitivit është: "Aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B. M., Në pikën II., të dispozitivit vërtetohet se e paditura Posta dhe Telekom i Kosovës – Telekom i Kosovës Sh.a., në mënyrë të kundërligjshme, paditësit B. M. i ka ulur gradën dhe pozitën nga udhëheqës i grupit servisit qendror për furnizim me energji elektrike dhe gjenerator me gradën 12 në pozitën mirëmbajtës i objektit me gradën 6. Në pikën III., të dispozitivit është obliguar e paditura Telekom i Kosovës sh.a në Prishtinë, që ta kompensoj paditësin për diferencën e pagës duke filluar nga data 14.04.2010 deri me datë 28.02.2012 dhe nga data 01.03.2012 deri me datë 31.12.2021 dhe atë t'i paguaj paditësit shumën neto prej 78,520.15 €, si dhe kamatën ligjore në shumën 61,348.91

euro, po ashtu t'i paguaj paditësit kontributin pensional në shumën prej 4,132.64 € dhe tatimin në paga në shumën prej 4,783.40 €, të gjitha këto në shumë bruto të përgjithshme prej 148,785.10 €, në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit ligjor. Në pikën IV., të dispozitivit është obliguar e paditura Telekom i Kosovës sh.a – Prishtinë, që paditësit, për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi 5,955.00 €, në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit ligjor. Në pikën V., të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit përtej pjesës së gjykuar edhe atë për pagesën pas përpilimit të ekspertizës financiare me të cilën paditësi kishte kërkuar që për çdo muaj të paguaj vlerën prej 282.39 euro së bashku me kamatën vjetore prej 8%, si e pa bazuar me ligj”.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3461/2022 të datës 05.03.2024, është miratuar ankesa e të paditurës Telekom i Kosovës, është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2803/2019 i datës 14.03.2022 dhe është refuzuar në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën kanë kërkuar që: “Të detyrohet e paditura Telekom i Kosovës, që për periudhën 14.04.2010 – 28.02.2012 dhe në mes gradës 12 dhe 8, për periudhën prej 01.03.2012 – 31.12.2021 t'ia paguaj shumën prej 82.652.79 €, kamatën ligjore në shumën 61,348.91 €, kontributin pensional në shumën 4,132.64 € dhe tatimin në paga shumën 4,783.40 €, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën 5,955.00 €”.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të aprovoj revizionin, ashtu që të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe të vërtetoj si të bazuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Pala e paditur me përgjigje në revizion ka kërkuar që Gjykata Supreme të refuzoj të pathemeltë revizionin e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e paditësit, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se:

Revizioni i paditësit është i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B. M., përmes të autorizuarit të tij, më datë 12.07.2011, ka parashtruar padi ndaj të paditurës Telekom i Kosovës, Sh.a., për shkak të shpërblimi të dëmit për shkak të mosrealizimit të ardhurave personale, ndërsa me parashtresën për precizimin e kërkesëpadisë së datës 09.02.2022, ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit për periudhën 14.04.2010 – 28.02.2012 dhe për periudhën 01.03.2012 – 31.12.2021 t'ia paguaj shumën prej 82.652.79 €, kamatën ligjore në shumën 61,348.91 €, kontributin pensional në shumën 4,132.64 € dhe tatimin në paga shumën 4,783.40€, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën 5,955.00 €.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me këtë çështje, ashtu siç është përcaktuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.2803/19 të datës 14.03.2022, elaboruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata e shkallës së parë më datë 14.10.2013 e miraton padinë e paditësit sipas aktgjykimit C.nr.1771/11, ndërsa pas ankesës nga ana e të paditurës Gjykata e Apelit me aktvendimin CA.nr.1174/14 të datës 22.06.2015 lëndën e kthen në rigjykim, ndërsa me aktvendimin C.nr.1472/15 të datës 25.01.2016 padinë e paditësit e hedhë si të pa afatshme. Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të ankesës së palës paditëse me aktvendimin Ac.nr.2924/16 të datës 25.07.2019, e aprovon ankesën të themeltë dhe lëndën e kthen në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, me aktgjykimin e datës 14.03.2022, të atakuar me ankesë ka vërtetuar gjendjen faktike se paditësi ka qenë i punësuar të e paditura sipas kontratës 0..., e datës 04.03.2005 dhe ishte i caktuar në pozitën inxhinier i makinerisë me koeficient sipas gradës 10, ndërsa me vendimin me numër 4188 të datës 16.10.2007, është caktuar në pozitën udhëheqës i grupit të servisit qendror i FE & GJ me gradën 12. Paditësi ka ushtruar të drejtën e tij siç është ushtrimi i ankesës në Komisionin e Ankesave, i cili komision e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit sipas vendimit 01-5803/10 të datës 24.11.2010 dhe iu rekomandon Burimeve Njerëzore që çështjen ta shqyrton edhe një herë dhe paditësin ta sistemojnë në vendin e punës bazuar në aftësitë profesionale që ka dhe në përputhje me gradën që ka pasur me kontratën paraprake. E paditura nuk e ka shqyrtuar asnjëherë vendimin e Komisionit të Ankesave dhe nuk i ka kthyer përgjigje sipas vendimit 01-5803/10 të datës 24.11.2010. Meqenëse e paditura nuk e ka zbatuar vendimin e lartpërmendur dhe nuk kishte dhënë asnjë përgjigje lidhur me zbatimin apo mos zbatimin e tij, paditësi ishte drejtuar gjykatës që kërkesën e tij të realizoj me padi.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit më tej ka theksuar se mënyra e sistemimit të punëtorëve bëhet në mënyrën e përcaktuar me ligj, konkretisht nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit të Punës është përcaktuar se: “Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuar në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës. Në rastin konkret e paditura ka vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore të sipërcituar ngase paditësit përveç se i është ndërruar pozita, i njëjti është degraduar në pagë dhe atë në 50% të pagës që e kishte me Kontratën e Punës me numër 0.., të datës 20.10.2005, si dhe me vendimin për risistemimin e punëtorit nr.4188, të datës 16.10.2007, si pjesë përbërëse e kontratës së lartcekur. Kjo gjykatë ka theksuar se lidhja e kontratës së punës në këtë formë duke obliguar paditësin që mos të jap asnjë vërejtje lidhur me kontratën e lartcekur, konsiderohet krijimi i marrëdhënies së punës në kundërshtim të plotë me dispozita e Ligjit të Punës, ngase për krijimin e marrëdhënies së punës duhet të ekzistoj vullneti i dyanshëm mes palëve kontraktuese. Në rastet kur punëmarrësi nuk pajtohet me ndërrimin e vendit të punës dhe uljen e gradës në pagës, atëherë e drejta për të atakuar një kontratë të tillë i takon punëmarrësit e jo siç ka vepruar e paditura në rastin konkret me paditësin. Në këtë kontest gjykata ka vlerësuar se nga provat e shqyrtuara ka rezultuar se paditësi është vënë në pozitë të pabarabartë në këtë çështje, andaj nga kjo arsye dhe arsyet e përmendura më lartë gjykata vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta

aprovuj në tërësi të bazuar, mbështetur edhe në nenin 5 të Ligjit të Punës, si dhe nenin 8 të Ligjit kundër Diskriminimit. Gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar saktë lartësinë e kërkesëpadisë administroi ekspertizën dhe plotësimin e ekspertizës të ekspertit R. B., i cili në elaboratin e tij ka theksuar se për periudhën kohore prej datës 14.04.2010 deri më 28.02.2012 paga e përllogaritur nga grada 12 në 6, dhe për periudhën prej 01.03.2012 deri 31.12.2021 paga e përllogaritur nga grada 12 në 8, paditësi do të kishte realizuar paga bruto 82,652.79 euro, ndërsa neto paga paditësi do të kishte realizuar 78,520.15 euro. Eksperti financiar kishte përllogaritur edhe kontributin personal që duhet të paguaj e paditura dhe atë shumën 4,132.64 euro dhe tatimin në burim shumën prej 4,783.40 euro, të cilës ekspertizë gjykata ia fali besimin në tërësi.

Sa i përket kamatës gjykata mori për bazë ekspertizën ku e përllogariti prej datës 01.05.2010 - 31.12.2010 në shkallë 4.6 % në vit, ndërsa prej 01.01.2011 - 31.12.2012 në shkallë 4.5 % në vit, si dhe prej 01.01.2013 - 31.12.2021, në shkallë 8 %, siç parashihet me nenin 382 të LMD-së është në shumë prej 61,348.91 euro. Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke detyruar të paditurën që paditësit në mes të kompensimit të dëmit, për shkak të pamundësisë se realizimit të diferencës së pagës të i'a paguaj shumat e gjykuara si në dispozitiv dhe atë bazuar në nenin 55 të Ligjit të Punës, paragrafit 1 në të cilin përcaktohet se: "I punësuari ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet në kontrate të punës, në pajtim me këtë ligj, në kontratën kolektive dhe në aktet e brendshme të punëdhënësit". Për bazë ligjore gjykata i është referuar neneve 5, 17 dhe 55 paragrafi 1, 78 paragrafi 1 dhe 79 të Ligjit të Punës dhe nenit 262 të LMD-së, ndërsa për kamatën ka vendosur bazuar në nenin 227 të LMD-së. Për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, ka aprovuar të themeltë ankesën e të paditurës dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Sipas kësaj gjykate rezulton se paditësi pretendon se e drejta e tij buron nga Vendimi i Komisionit të Ankesave 01-5803/10, të datës 24.11.2010. Lidhur me këtë kjo gjykatë, ka gjetur se të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit në këtë çështje janë rregulluar me Kontratën e Punës, Nr.0., të datës 14.04.2010, në të cilën kontratë të punës, ndër të tjera është përcaktuar edhe lartësia e pagës. Është vlerësuar se paditësi nuk ka shfaqur pretendime nga padia se nuk është trajtuar dhe nuk i janë paguar të ardhurat konform kontratës së punës, apo i është bërë shkelja e ndonjë të drejte tjetër që buron nga një kontratë e tillë, po ashtu është vlerësuar se askush askënd nuk mundet që ta detyrojë të lidhë Kontratën e Punës, kjo mbetet në vullnetin e dyanshëm të punëdhënësit dhe të punësuarit, prandaj edhe nuk mund të qëndrojnë pretendimet e paditësit si nga padia se një kontratë të tillë e ka nënshkruar nën çfarëdo presioni të ushtruar nga ana e të paditurës. Lidhur me pretendimet e paditësit se e paditura nuk ka zbatuar rekomandimet e Komisionit të Ankesave lidhur me ri sistemimin, Gjykata e Apelit gjen se asnjë vendim ose akt tjetër nga marrëdhënia e punës, nuk do të mund të zëvendësojë atë që është përmbajtur në kontratën e punës të nënshkruar nga të dy palët punëdhënësi dhe punëmarrësi, dhe çfarëdo ndryshimi të mëvonshëm në përmbajtjen e kontratës së punës, palët duke u bazuar në dispozitat ligjore, munden që ta bëjnë vetëm me vullnetin e dyanshëm. Për arsyet e theksuara si më lartë, kjo gjykatë vlerëson se një qëndrim i tillë juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, ngase sipas vlerësimit

të gjykatës së shkallës së dytë, mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike, në mënyrë të gabuar është zbatuar e drejta materiale, kur gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar. Në nenin 201 paragrafi 1 është përcaktuar se: “Gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes kryesore drejtpërsëdrejti, me aktgjykim e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë, po që se konstaton se ekziston ndonjëri nga këto shkaqe të treguara në ankesë: d)... nëse konsideron se gjendja faktike e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë është konstatuar drejte, por e drejta materiale është zbatuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë”. Nga të gjitha arsyet e paraqitura e me zbatimin e nenit 201 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon të bazuar revizionin e paditësit, pasi që nuk mund të pranoj si të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë, kjo për shkak se aktgjykimin e gjykatës së shkallë së dytë është marrë në kundërshtim me dispozitat nga neni 182.2, pika c), lidhur me nenin 204 dhe 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Gjykata Supreme e vlerëson të bazuar pretendimin në revizionin e paditësit, se me rastin e vendosjes në procedurën ankimore, kolegji i Gjykatës së Apelit vendimmarrjen e ka bërë me anëtarë të kolegjit, e cila ka qenë e përfshirë në procedurë në shkallë të parë, respektivisht e njëjta anëtare kolegji (Hunaida Pasuli), ka ndërmarr veprime në këtë lëndë edhe gjatë zhvillimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë. Në lidhje me këtë, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ndaj të paditurës ka iniciuar dy padi në gjykatën e shkallës së parë, të evidentuara me shenjen C.nr.1580/11 dhe C.nr.2803/19, të cilat me aktvendimin e marr në procesverbalin për shqyrtim kryesor C.nr.2803/19, datë 02.03.2021, janë bashkuar të dy lëndët dhe procedura për këtë çështje ka vazhduar nën shenjen C.nr.2803/19. Ndërsa gjyqtarja në fjalë në lëndën C.nr.1580/11, ka mbajtur seancë përgatitore me datë 05.04.2013, ku prezent kanë qenë palët ndërgjyqëse, si dhe ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi të datës 13.03.2013, palës së paditur. Si rezultat i kësaj, gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPK-së, përkatësisht në rastin konkret janë evidentuar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 67 pika d), lidhur me nenin 182.2 pika c), e që për Gjykatën Supreme është bazë e mjaftueshme procedurale për ta prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, në pajtim me nenin 214 paragraf 1 pika a) të LPK-së (neni 9 i LPK-së së ndryshuar). Në lidhje me këtë, vlerësohet e domosdoshme ruajtja e parimit të dyshkallshmërisë dhe objektivitetit të gjykatës në trajtimin dhe vendosjen e ankesave në procedurë ankimore.

Në anën tjetër, kjo gjykatë vlerëson se me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion, Gjykata e Apelit nuk ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet thelbësore të ngritura para gjykatës së shkallës së dytë. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata e shkallës së parë, mirëpo nuk ka dhënë asnjë arsye për një konstatim të tillë, gjë që nuk mund të kuptohet se cili është vlerësimi i kësaj gjykate në raport me pretendimet ankimore të ngritura nga pala e paditur, e që kanë të bëjnë me aplikimin e të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë. Për më tepër kjo gjykatë nuk ka cituar asnjë

dispozitë ligjore nga e drejta materiale e zbatuar, e as nuk ka dhënë asnjë vlerësim sa i përket dispozitave materiale që janë aplikuar nga gjykata e shkallës së parë, duke mos dhënë asnjë vlerësim në lidhje me atë se cilat fakte kanë quar në një përfundim të tillë, marrë për bazë arsyet e paraqitura si më sipër.

Për shkak të shkeljeve të tilla, Gjykata Supreme vlerëson se çështjen duhet ta kthej në gjykatën e shkallës së dytë, kjo me qëllim që Gjykata e Apelit duke marrë për bazë ankesën e të paditurës, të shqyrtoj të gjitha pretendimet ankimore dhe të jap arsye të qarta ashtu siç është përcaktuar me nenin 204 të LPK-së dhe brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë e sipas nenit 194 të LPK-së. Duhet pasur parasysh se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Përveç kësaj, në rivendosje nuk duhet të merr pjesë anëtarja e kolegjit e cila ka ndërmarr veprime në procedurën e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, me qëllim të ruajtjes së parimit të dyshkallëshmërisë dhe objektivitetit të gjykatës në procedurën ankimore.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 224 paragrafi 2, të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Rev.nr.443/2024, datë 27.01.2025

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Lumni Sallauka